

FJALA E DEPUTETES ILDA DHORI

E ENJTE 17 NËNTOR 2022

Përshëndetje të dashur qytetarë,

Jemi duke folur për vaksinën në fakt, dhe shkencëtarët në botë ia gjetën vaksinën virusit të tmerrshëm, i cili mori miliona jetë të pafajshme dhe le të themi që sot kemi një armë më shumë. Po vaksinën për ju, si do ta gjejnë shqiptarët, vaksinën ndaj kësaj qeverie arrogante, e cila vetëm do t'i zhasë, t'i vjedhë çdo ditë? Këtë vaksinë, si do ta gjejnë shqiptarët? Jemi ende në kërkim për ta gjetur këtë vaksinë dhe për t'ju larguar një orë më parë. Vaksinimi përmirëson imunitetin, forcon rezistencën ndaj viruseve të të gjitha llojeve dhe formave, por oksigjeni shëron, oksigjeni është domosdoshmëri për të marrë frymë çdo ditë. Këtë jeni duke bërë ju, jeni duke i privuar shqiptarët nga oksigjeni.

Ç'na duhet vakcina, kur na privoni oksigjenin e përditshëm? Këtë jeni duke bërë me qeverinë tuaj, me ministrinë tuaj dhe ministren tuaj kampione në krye të ministrisë më arrogante. Mirela Kumbaro dëshiron dhe është e vendosur me arrogancën e saj të vendosë taksë për oksigjenin. Me paturpësinë më të madhe thotë para shqiptarëve: "50 lekë për çdo këmbësor për të marrë oksigjenin e parkut kombëtar janë shumë pak". Në fakt, zonja Ministre, pak është në këndvështrimin tuaj, sepse në këndvështrimin e shqiptarëve të Divjakës, të Lushnjës, të të gjitha zonave përreth, që e kanë një nga atraksionet e përditshme parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta, nuk flitet për tarifë, nuk luftohet për tarifë, por luftohet, protestohet, rezistohet dhe do të vazhdojë të rezistohet për dinjitet.

Dinjiteti njerëzor mund të jetë i vetmi që ju nuk na e keni marrë ende deri më sot, por tentoni me arrogancë dhe në kundërshtim të hapur me ligjin të na e merrni edhe dinjitetin, por nuk do t'ia dilni, kjo është pak por e sigurt. Ndërkohë, rezistenca do të vazhdojë, do të jemi aty, sepse jemi duke mbrojtur një kauzë të drejtë. Divjaka, Lushnja, të gjitha zonat përreth, të gjithë shqiptarët janë në mbështetjen tonë, sepse të gjithë frekuentojnë sot pasurinë më të madhe natyrore të këtij vendi, më të paprekurën, me sipërfaqe më të madhe, parkun e Divjakës dhe bashkë me të plazhin e Divjakës, një plazh publik me një vijë të gjatë bregdetare, i cili nuk mundet kurrsesi të bllokohet me anë të një trau të shëmtuar metalik, që ministrja e quan "biletari elektronike".

Ky është termi i bukur me të cilin e maskon. Në fakt, është shëmtia më e madhe e thënë nga goja e një ministreje, për një akt të shëmtuar që do të bllokojë jo vetëm kalimin e automjeteve në parkun

kombëtar, në plazhin publik të Divjakës, por edhe bllokimin e kalimit të këmbësorëve. Ky është absurditet. Më thoni, zonja Ministre, e dashur Mirela Kumbaro, në cilin plazh publik si ai i Divjakës në Shqipëri, në rajon, në Europë, në botë, hyhet për të bërë një xhiro më këmbë duke paguar një taksë, taksim për ajrin? Kjo është vjedhja më e madhe që ju doni t'i bëni kësaj zone dhe të gjithë Shqipërisë, në fakt.

Zonja Ministre, ju informoj, sepse ndër të tjera jeni edhe e keqinformuar apo akoma më keq e painformuar: Parku Kombëtar Divjakë - Karavasta vjel të ardhura nga vizitorët që hyjnë ta vizitojnë dhe i merr këto para pa dhënë kupon tatimor. Absurde. Shteti kërkon rregull nga biznesi, shteti kërkon kuponin tatimor dhe vjedh qytetarët që hyjnë, që parkojnë në sezonin veror në bregun e detit apo që kryejnë një xhiro me varkë, apo ata që vizitojnë Kullën 360 gradë, duke u marrë para pa kupon tatimor. Kjo është vjedhja juaj, megjithëse nuk jeni të informuar dhe ju nuk jeni e informuar si ministre. Patjetër që origjinohen para, prej vitesh merren para për parkimin dhe para të deklaruara, të marra pa kupon tatimor në vitin 2017 kanë qenë 9 milionë e 780 mijë lekë; në vitin 2018, 12 milionë lekë; në vitin 2019, 12 milionë e 800 mijë lekë; në vitin 2020, 21 milionë lekë; në vitin 2021, 15 milionë e 720 mijë lekë.

Pra, ju thoni se do të rrisni qëndrueshmërinë financiare të sistemit të zonave të mbrojtura duke ua dhënë privatit, duke privuar kalimtarët të hyjnë në parkun kombëtar. Në fakt, janë të qëndrueshme, se vetëm të deklaruarat shkojnë, absurde, në buxhetin e bashkisë Divjakë. Nuk e di sesa shkojnë nëpër xhepa, por këto janë të deklaruara në një përgjigje zyrtare që kanë shkuar në buxhet. Ku janë këto para për mirëmbajtje? Sepse janë të qëndrueshme. Janë të qëndrueshme nga viti në vit. Kjo është pjesa më e vogël e këtyre të ardhurave, sepse është sezonale, por pjesa më e madhe që gjenerohet është deri në 30 milionë në muaj nga shëtitjet me barka, nga vizitat në Kullën 360 gradë.

Të gjitha këto para shkojnë nëpër xhepa, në arka dhe askund në park. Parku vazhdon të jetë i paprekur, vazhdon të jetë siç e ka bërë Zoti, natyra dhe absolutisht që ju nuk mundet dhe nuk do ta pushtoni. Ndër të tjera, zonja Ministre, ju kujtoj se ekziston një vendim gjykate i vitit 2011, i cili e ka shpallur të paligjshëm traun e 10 vjetëve më parë, e ka shpallur një shkelje të hapur të ligjit, të lirive, të të drejtave të qytetarëve, të njeriut në tërësi. Po çfarë bën qeveria juaj? Miraton një VKM për zonat e mbrojtura. Por këtu jeni treguar pak të painformuar, sepse aty veçse është parku, është edhe plazhi, mbi të gjitha.

Kjo VKM vendos një privat që do të ngrejë biletarinë elektronike në hyrje të parkut, i cili do të vjelë shqiptarët, do të administrojë paratë e shqiptarëve me origjinë finale të panjohur. Kjo VKM, zonja Ministre, ju informoj që është në kundërshtim të vendimit të gjykatës të këtij vendi. Është vendimi i

Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Lushnjë, e vitit 2011, për traun e atëhershëm, sepse bllokohej kalimi në plazhin publik të Shqipërisë, të Divjakës, konkretisht. Kështu që ne do ta vazhdojmë së bashku me banorët këtë kauzë, madje ata nuk duan të tërhiqen nga kjo kauzë. Do ta fitojmë këtë kauzë, sepse është kauza jonë, kauza e drejtë, kauza e ligjshmërisë, kauza e mosnënshtrimit, kauza e lirisë, kauza e frymëmarrjes, e oksigjenit. Sepse jemi duke folur për shëndetin, për oksigjenin dhe ne do ta fitojmë kauzën e oksigjenit. Kjo është pak, por e sigurt.

Kështu që ata njerëzit punëtorë, të mirë, fjalëpak, të ndershëm, të Divjakës, të cilët nuk i detyrohen asgjë pushtetit tuaj arrogant dhe zhatës, do të vazhdojnë në kauzën e tyre të drejtë, sepse u intereson shumë më tepër ajo lëvizja e lirë në vendin e tyre, në tokën e tyre, frymëmarrja pa i marrë leje askujt dhe kauza e drejtë, sesa çdo gjë tjetër, sesa servilizmi ndaj jush dhe nënshtrimi. Kështu që, kurrë nuk do ta keni këtë. Pa dyshim rruga ligjore do të jetë bashkërisht me rrugën e demonstrimit, qëndrimit, rezistencës sonë, e cila do të rritet dhe do të vazhdojë edhe nesër, ka qenë në rritje çdo ditë dhe pa dyshim që nuk do të lejohet një çmenduri e tillë nga ana e Mirela Kumbaros dhe cilësdo kompanie private, që me firmën e saj kërkon të marrë, të aneksojë, të privatizojë një pasuri publike të Divjakës dhe të të gjithë shqiptarëve. Faleminderit!